V E N D I M
Nr.248, datë 27.5.1993

PËR DISA MASA PËR SHPEJTIMIN E PRIVATIZIMIT TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA E TË MESME

Me propozimin e Bordit të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ndërmarrje, në këtë vendim, konsiderohen punishtet, restorantet, hotelet, dyqanet, magazinat etj., si dhe pjesë të tyre, me vlerë jo më të madhe se kundërvlefta në lekë e 500.000 USD ose jo më tepër se 300 punonjës.

- Me AKP kuptohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

2. Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme do të bëhet kryesisht me ankand, të organizuar nga degët e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rrethin ku ndodhet ndërmarrja.

Privatizimi bëhet pa ankand vetëm për ish-pronarët, në zbatim të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave të ish-pronarëve", si dhe për persona juridikë dhe fizikë të veçantë, për këta të fundit me vendim të Bordit drejtues të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit ose të Bordit të degës së AKP në rreth.

Privatizimi do të bëhet pa ankand edhe për ato ndërmarrje që janë vendosur shprehimisht me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

3. Nëpërmjet kontrollit të pjesëmarrjes në ankand nuk do të lejohet që prona shtetërore të kalojë në duart e njerëzve të korruptuar, si dhe do të përzgjidhen njerëzit më të përshtatshëm, me kriterin që të mos koncentrohen shumë ndërmarrje në duar të një personi, me qëllim që sa më shumë vetë të kthehen në pronarë etj. Nuk lejohen të marrin pjesë në ankand as personat juridikë shtetërorë ose edhe ata privatë ku shteti zotëron mbi 20 për qind të pasurisë apo aksioneve.

Ankandi do të jetë publik, transparent, por duke u dhënë precedencë në radhë të parë punonjësve të ndërmarrjeve që privatizohen, në radhë të dytë shtetasve shqiptarë dhe pastaj shtetasve të huaj.

4. Procedura e ankandit fillon pasi të jenë plotësuar dokumentet e vlerësimit individual të ndërmarrjes. Kur ndërmarrja funksionon me aktivitet të privatizuar dhe qiramarrësit vërtetojnë me dokumente se kanë bërë investime që i kanë rritur vlerën objektit këto investime i shtohen vlerës së objektit, duke u indeksuar me çmimet në datën e përgatitjes për ankand dhe duke i ulur amortizimin. Pas shitjes së objektit u kthehet kjo vlerë qiramarrësve.

Dega e AKP jo më vonë se 30 ditë para datës në të cilën mbaron afati i pranimit të ofertave të ankandit fillon publikimin e privatizimit të këtyre ndërmarrjeve, duke kryer hapat e mëposhtëm:

a) Vendos një reklamë në dy nga gazetat me qarkullim kombëtar në të paktën 4 herë, jo më vonë se 3 javë para datë së fundit për pranimin e ofertave.

b) Vendos një reklamë në një gazetë të rrethit ku do të ndodhë shitja, të paktën 4 herë dhe jo më vonë se 3 javë para datës së fundit për pranimin e ofertave. Kur nuk ka gazetë lokale, bëhet njoftim me afishe, por jo më pak se në 4 vende dhe jo më pak se 4 herë.

Këto reklama do të specifikojnë informacionin e mëposhtëm:

- Emrat dhe vendet e njësive që privatizohen.
- Përshkrimi i aktivitetit të ndërmarrjes ose pjesës së saj që shitet.
- Përshkrimi i përgjithshëm i të gjitha pasurive që disponon njësia që shitet.
- Çmimi i fillimit të ankandit.
- Emrat, adresa dhe numrat e telefonit të degëve të AKP që përfshihen në proces, si dhe personat përgjegjës për ndërmarrjet.
- Një kujtesë, se një informacion më i hollësishëm është në dispozicion në degën e AKP dhe për mundësinë e kontaktimit me drejtuesin e njësisë.
- Data dhe vendi i zhvillimit të ankandit dhe periudha e pranimit të kërkesave.

c) Në qoftë se është e mundur, do të organizohet edhe reklama televizive apo radiofonike.

5. Kryetari i degës së AKP përpilon dhe arkivon një procesverbal që përmban:

a) Emrin e gazetës, datat e reklamës dhe një kopje të saj.

b) Numrin e afisheve të vendosura, vendet ku janë vendosur dhe datat e vendosjes.

Procesverbali duhet të ruhet së paku 1 vit pas shitjes së ndërmarrjes.

6. Kushdo që dëshiron të blejë ndërmarrje duhet të paraqesë kërkesë me shkrim si dhe:

a) Një dëftesë që tregon pagesën prej 10 për qind të çmimit të blerjes në numrin e llogarisë të specifikuar më poshtë.

b) Një deklaratë me shkrim për prejardhjen e parave.

Me anën e kësaj deklarate nënshkruesi siguron nën përgjegjësinë e tij personale se prejardhja e parave të tij është në rrugë legale, të ndershme dhe me apo pa pjesëmarrje të kapitalit të huaj.

c) Listën me firmat e grupit të punonjësve të ndërmarrjes që janë dakord të bëhen bashkëpronarë të ndërmarrjes, kuotën fillestare të paguar nga secili dhe emri i përfaqësuesit të tyre në ankand. Kjo listë duhet të jetë e vërtetuar me firmën e drejtorit të ndërmarrjes ose likuidatorit të saj.

ç) Ofruesit mund të paraqesin një plan biznesi që do të sigurojë informacion lidhur me përdorimin e kësaj njësie, prodhimin dhe kostot e planifikuara, investimet shtesë, strategjinë e biznesit, numrin e punonjësve që do të punojnë etj.

7. Pagesa bëhet në çdo degë të Bankës Kombëtare Tregtare të Shqipërisë me llogarinë 616/110 të AKP.

8. Ish-pronari i truallit, kur kërkon të blejë ndërmarrjen që shtrihet mbi truallin ish-pronë e tij, duhet të paraqesë në degën e AKP-së të rrethit dokumentacionin e plotë që vërteton se ai është pronar i truallit, të vërtetuar edhe nga organi përkatës i ngarkuar me dispozitat përkatëse në zbatim të ligjit "Për kthimin dhe kompesimin e pronave të ish-pronarëve". Në këtë rast ai merr autorizim nga dega e AKP për të paguar llogarinë e Bankës, të dhënë në pikën 7, shumën e caktuar të fillimit të ankandit. Pagesa dhe paraqitja e kopjes së dëftesës së pagesës në degën e AKP duhet të bëhet brenda afatit të pranimit të kërkesave të pjesëmarrjes në ankand.

Në rastet kur plotësohen kërkesat e mësipërme, ndërpritet procedura e ankandit dhe dega e AKP të rrethit nxjerr një lajmërim në dy gazetat kombëtare, një në gazetën e rrethit ose një lajmërim në një vend të dukshëm, ku tregohet se ndërmarrja tashmë do t'i shitet ish-pronarit të truallit.

Në rastet kur ish-pronari i truallit nuk përmbush kërkesat dhe afatet e mësipërme, ai humb të drejtën e blerjes pa ankand.

9. I gjithë materiali i përshkruar në pikat 5 dhe 6, në ditën e mbarimit të afatit të pranimit të kërkesave mbyllet nga dega e AKP dhe mbahet në dispozicion për t'u paraqitur në mbledhjen e bordit të degës së AKP të rrethit apo të AKP. Kryetari i degës së AKP u dorëzon me shkrim, dorazi, lajmërimin për qënien gati të materialit për ankand: një kopje i jepet kryetarit të këshillit të rrethit dhe një kryetarit të bashkisë së qendrës së rrethit. Ata duhet të lajmërojnë degën e AKP të rrethit se kur dhe ku do të mbidhet bordi i degës së AKP në rreth.

10. Bordi i degës së AKP në rreth përbëhet nga personat e mëposhtëm:

1. Kryetari i degës së AKP të rrethit
2. Kryetari i këshillit të rrethit
3. Kryetari i bashkisë
4. Sekretari i rrethit
5. Kryetarët e këshillit bashkiak
6. Sekretari i bashkisë së qendrës
7. Shefi i financës së rrethit
8. Shefi i financës së bashkisë së qendrës
9. Shefi i kontroll-revizionit i rrethit
10. Shefi i tregtisë së rrethit
11. Shefi i ekonomisë së rrethit
12. Drejtuesi i D. Bujqësore
13. Drejtues i D. Arsimit
14. Kryetari i degës së kontrollit të shtetit
15. Kryetari i zyrës së tatimeve
16. Kryetari i dhomës së tregtisë
17. Drejtori i Bankës
18. Kryetari i policisë financiare
19. Kryetari i SHIK-ut
20. Kryetari i degës së rendit publik

21. Kryetari i zyrës së punës

Në vartësi nga numri i bashkive të rrethit, anëtarët e bordit mund të jenë mbi 21 veta.

11. Të gjithë emrat e kandidatëve dhe dokumentacioni i tyre për në ankand paraqiten në mbledhjen e bordit të degës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit të rrethit apo bordit të Agjensisë Kombëtare të Privatizimit, sipas vartësisë përkatëse të ndërmarrjes, lokale apo nacionale. Bordi i degës së AKP ka të drejtë të bëjë përzgjedhjen e personave që do të marrin pjesë në ankand si dhe të verë kushte në ankand, siç mund të jenë: ndërmarrja nuk duhet të ndërrojë destinacionin për dy vjet, apo s'duhet rishitur po brenda 2 vjetëve etj. Bordi i AKP ka edhe të drejtat e mësipërme edhe të drejtën të delegojë shqyrtimin e kandidatëve për ankand për privatizimin e ndërmarrjes nacionale në bordin e degës së rrethit përkatës. Në këtë rast bordi i degës së AKP në rreth merr të gjitha të drejtat si për ndërmarrjet lokale.

Bordi merr vendim me shumicë absolute të votave. Gjykimi nuk duhet të influencohet në asnjë mënyrë nga motive politike.

Në qoftë se brenda 20 ditëve nga dorëzimi i lajmërimeve për qënien gati të materialit, bordi i degës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit të rrethit ose i AKP nuk ka kthyer përgjigje, konsiderohet se ka vendosur që në ankand të marrin pjesë të gjithë kandidatët e paraqitur.

12. Bordi i degës së AKP në rreth ka të drejtë që, mbi bazën e leverdisë së qartë sociale, ekonomike, kulturore etj., ose dhe mbi bazën e trajtimeve të biznesplanit e projektkontratave eventuale me ndonjërin nga kandidatët, të vendosë me shumicë absolute të votave privatizimin pa ankand në favor të grupit të punonjësve, apo të një personi fizik apo juridik të veçantë.

Në qoftë se ndërmarrja ka çmim fillestar të ankandit (pa investimet e qiramarrësve) që nuk kalon kundër vleftën në lekë të 100 mijë USD, ose numri total i punonjësve nuk kalon 50 vetë, atëhere vendimi i bordit të degës së AKP në rreth është i formës së prerë. Kur ndërmarrja i tejkalon këta tregues, vendimi i bordit të degës së AKP në rreth i dërgohet menjëherë AKP. Ajo merr mendimin e nënkomisionit të privatizimit të ministrisë përkatëse që mbulon aktivitetin. Në qoftë se mendimi i këtij nënkomisioni përputhet me vendimin e bordit të degës së AKP në rreth, vendimi i bordit merr formën e prerë dhe AKP ia kthen degës së AKP në rreth për veprim. Në qoftë se mendimi i nënkomisionit të ministrisë nuk përputhet me vendimin e bordit të degës së AKP në rreth, atëhere i gjithë dokumentacioni i paraqitet për shqyrtim bordit të AKP. Kryetari i bordit mund të ftojë në mbledhje edhe një përfaqësues të bordit të degës që ka votuar me shumicën si dhe kryetarin e nënkomisionit të privatizimit të ministrisë përkatëse. Vendimi i bordit të AKP është i formës së prerë dhe i dërgohet degës së AKP në rreth për veprim.

E gjithë kjo procedurë nuk duhet të kalojë më tepër se 45 ditë. Në qoftë se kalohet ky afat, vendimi i bordit të degës së AKP në rreth merr formën e prerë.

13. Ora e saktë e fillimit të ankandit si dhe lista e pjesëmarrësve në ankand shpallen jo më vonë se 2 ditë pas marrjes së vendimit të bordit të degës ose kalimit të afatit 20 ditor, ose 5 ditë pas vendimit të bordit të AKP. Shpallja bëhet në një vend të caktuar në rrethin ku zhvillohet ankandi.

Në qoftë se ndryshohet data e zhvillimit të ankandit, duhet të lajmërohen të gjithë ofruesit pjesëmarrës në ankand jo më vonë se 5 ditë para datës së re.

14. Kur formohet grup me punonjës të ndërmarrjes që duan të bëhen bashkëpronarë të saj, gjatë ankandit, ato ose përfaqësuesi i tyre, kanë të drejtën e shprehjes të parët. Çmimi i ofruar prej tyre mund të rëzohet vetëm me propozimet e tjera që përmbajnë çmime më të mëdha se çmimi i ofruar nga grupi i punonjësve të ndërmarrjes i shumëzuar me koefiçientin e favorizimit.

Pjesëtarët e grupit të punonjësve të ndërmarrjes duhet të kenë paguar secili jo më pak se 10 për qind të pjesës mesatare që u takon sipas çmimit fillestar të ankandit. Në qoftëse se grupi i punonjësve të ndërmarrjes e blen ndërmarrjen, ai duhet që të formojë menjëherë një shoqëri kolektive apo të një forme tjetër. Secili pjestar ka të drejtë të ruajë përqindjen e tij që buron nga pagesa fillestare e mësipërme, duke bërë pagesën shtesë përkatëse ose dhe të mbetet në sasinë e paguar fillimisht, duke iu ulur përkatësisht pjesa e tij në shoqëri.

Mund të jetë pjestar si punonjës i ndërmarrjes edhe punonjësi në asistencë që ka qenë punonjës i ndërmarrjes deri 12 muajt e fundit.

Kur ndërmarrja që shitet është e ushqimit social, me aktivitet prodhues apo artizanal dhe vepron me aktivitet të privatizuar që prej më tepër se 12 muajsh nga data e shpalljes së ankandit, punonjës të ndërmarrjes konsiderohen vetëm personat që punonin në të gjatë aktivitetit privat.

Koeficienti i favorizimit në ankand llogaritet nga formula:

$$1+2 \times \frac{\text{Numri i punonjësve të ndërmarrjes në grup - 1}}{\text{Numri total i punonjësve të ndërmarrjes}} ; < 3$$

Numri total i punonjësve të ndërmarrjes merret sa numri mesatar i punëtorëve gjatë 12 muajve të fundit para fillimit të ankandit.

15. Kur në ankand marrin pjesë persona me shtetësi të huaj ose me kapital të përbashkët me shtetas shqiptarë, këta do të shprehen pas personave me shtetësi shqiptare. Çmimi i ofruar nga shtetasit shqiptarë mund të rrëzohet me propozimet e të huajve që janë më të mëdha se çmimi i ofruar nga shqiptarët e shumëzuar me koefiçientin 3 edhe kur konkuron me punonjësit dhe me koefiçientin e favorizimit të punonjësve të ndërmarrjes.

Çmimi i fillimit të ankandit konsiderohet si ofertë e parë e shtetasve shqiptarë jopunonjës të ndërmarrjes.

16. Përgjegjësi dhe organizatorët e ankandit kanë këto detyra:

a) Të sigurojnë që para nisjes së ankandit që të gjithë pjesëmarrësit në ankand të jenë regjistruar, të jenë të identifikuar dhe të kenë dhënë numrin e tyre të pasaportës.

b) Të paraqesë anëtarët e komisionit te pretendentët.

c) Të deklarojë çmimin fillestar të ankandit.

ç) Të shpallë personin e fundit që deklaron çmimin më të lartë si fitues i ankandit.

d) Të drejtojë dhënien e ofertave.

dh) Të sigurojë që dhënia e ofertave të vazhdojë deri sa të ketë oferta të tjera përpara shpalljes së fituesit. Organizuesi i ankandit është i detyruar të deklarojë vleftën e ofertës fituese 3 herë, në mënyrë që të lejojë gjithë pjesëmarrësit që të paraqesin ofertat finale.

e) Të sigurojë që raporti i përfundimit të ankandit të firmoset edhe nga fituesi i ankandit.

17. Në raportin përfundimtar të ankandit duhet:

- Të tregohet dhe vërtetohet rregullshmëria e drejtimit ligjor të ankandit.
- Të dëshmohet se ofertat janë dhënë në përputhje me kushtet e përcaktuara.
- Të regjistrohen emrat dhe veçoritë e ofruesve.
- Të regjistrohen parregullsitë ose deklaratat për parregullsitë.
- Të regjistrohen çmimi dhe pala fituese.
- Të regjistrohet dëshmia e pagesës nga pala blerëse.
- Të regjistrohen pasuritë e blera nga blerësi.

18. Në qoftë se fituesi i ankandit, brenda 15 ditëve, nuk paguan shumën për të cilën ka firmosur raportin e përfundimit të ankandit, procesi i shitjes me ankand rifillon për së pari në një datë brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të afatit 15 ditor. Procesi rifillon që nga pika 4.

Depozita e shumës 10 për qind e vlerës së fillimit të ankandit të personit që fitoi ankandin dhe nuk paguan vlerën, nuk kthehet. Kjo e ardhur konsiderohet e ardhur neto dhe ndahet sipas pikave 19 e 20.

- Blerësi ka të drejtë të bëjë pagesën edhe me kredi të marrë nga banka apo shoqëri të tjera kredidhënëse.

19. Nga çmimi i shitjes në ankand deri në 20 për qind e tij i vihet në dispozicion këshillit drejtues të ndërmarrjes së shitur ose likuidatorit, si fond për t'u ndarë proporcionalisht në punonjësit e saj. Mund të shpërblehen edhe punonjës të ndërmarrjes që janë në asistencë. Ndarja bëhet në varësi të meritave në privatizim, vjetërsisë dhe aftësisë në punë e të tjera, por asnjë punonjës nuk duhet të marrë më shumë se 24 paga mesatare mujore. Paga mesatare mujore merret sa ajo e ministrisë që mbulon llojin e aktivitetit të ndërmarrjes, pa përfshirë kompensimet për bukën etj.

Kur ndërmarrja që shitet ka funksionuar me aktivitet të privatizuar që prej më tepër se 12 muajsh, paga mesatare e punonjësve përllogaritet sa rroga mesatare e ministrisë ku bën pjesë ndërmarrja.

Nuk përfitojnë nga ky shpërblim ata që:

a) Kanë vjetërsi në ndërmarrjen që u privatizua, më pak se 12 muaj. Ky kusht nuk zbatohet për drejtuesin kryesor (drejtori apo përgjegjësi) si dhe deri dy drejtues të tjerë si kryetar dege, shefi i

financës, kryespecialisti, likuidatori etj., sipas përcaktimit të organit të emërtesës.

b) Kanë vjetërsi të përgjithshme në punë shteti më pak se dy vjet. Ky kusht nuk zbatohet për ish-të burgosurit, të internuarit apo të dëbuarit politikë.

c) E kanë marrë një herë një shpërblim të tillë gjatë privatizimit të një ndërmarrjeje tjetër.

20. Të ardhurat nga shitja e objekteve ndahen:

- 2 për qind agjencisë së privatizimit.
- 28 për qind buxhetit të pushtetit lokal.
- 70 për qind Buxhetit të Shtetit dhe punonjësve të ndërmarrjes (sipas pikës 19).

Fondet e mësipërme korrigjohen duke ua zbritur gjendjen kontabël (diferenca debitor-kreditor) si vijon:

- 6 për qind e gjendjes kontabël për pushtetin lokal.
- 4 për qind e gjendjes kontabël punojësit e ndërmarrjes.

Kur ndërmarrja është me bilanc pozitiv, nuk bëhet korrigjim.

Pjesa tjetër e gjendjes kontabël kalon në Buxhet të Shtetit.

- Të ardhurat për buxhetin e pushtetit lokal (28 për qind) ndahen ndërmjet kryesisë së rrethit dhe bashkive, proporcionalisht me fondet buxhetore të tyre.

21. Mbeten në fuqi të gjitha aktet e Këshillit të Ministrave si dhe pjesë të tyre që nuk bien në kundërshtim me këtë vendim.

22. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Privatizimit, degët e saj në rrethe si dhe kryesitë e rretheve dhe bashkitë të veprojnë menjëherë për zbatimin e këtij vendimi. Ndërmarrjet që janë në proces shitjeje, duhet ta përfundojnë atë duke zbatuar këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi